



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

**MINISTRIA E ARSIMIT, E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË**

**MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE**

**MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY**

Kabineti I ministrit

Kabinet ministra

Cabinet of the minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

**MUNDËSIA DHE PROCEDURAT E REALIZIMIT TË PROCESIT TË
AVANCIMIT TË NXËNËSVE**

NUMËR:6/2009

DATE: 20.03.2009

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 12. 4 të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe me nenin 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është që të përcaktojë:
 - 1.1 mundësinë dhe procedurën e realizimit të procesit të avancimit të nxënësve;
 - 1.2 kushtet, kriteret dhe mënyrën e realizimit të avancimit të nxënësve;
 - 1.3 të drejtën e avancimit të nxënësve.

Neni 2
Propozimi dhe shqyrtimi i propozimit

1. Procedura për avancim të nxënësit fillon të realizohet me propozimin e:
 - 1.1 mësuesit të klasës;
 - 1.2 mësimdhënësit të lëndës;
 - 1.3 kujdestarit të klasës;
 - 1.4.këshillit të klasës.

2. Propozimin e shqyrton këshilli i arsimtarëve, i cili sugjeron për vazhdimin e procedurës për avancim, ndërsa drejtori është i obliguar të bëjë raportin me shkrim me arsyetim për avancimin.
3. Nxënësi i cili propozohet për avancim, vazhdon mësimin në klasën ekzistuese të vitit përkatës deri në mbarim të vitit shkollor.
4. Procedurat për avancim fillojnë në gjysmëvjetorin e dytë të vitit përkatës.

Neni 3

E drejta për avancim

1. Të drejtën për avancim e fitojnë :
 - 1.1 nxënësit me njohuri të përgjithshme dhe me sukses të dalluar;
 - 1.2 nxënësit me talent në ndonjë lëndë apo fushë lëndore;
 - 1.3 nxënësit me nevoja të veçanta.

Neni 4

Dokumentacioni

Për avancimin e nxënësve duhet përgatitur:

1. Propozimin me arsyetim me shkrim nga propozuesi.
2. Raporti me shkrim nga Këshilli i arsimtarëve i cili ka shqyrtuar propozimin.
3. Rezultati i testit të inteligjencës.
4. Suksesi nga vitet e mëparshme të shkollimit.
5. Dëshmi për talentin që e posedon nga lënda apo fusha lëndore.

Neni 5

Llojet e avancimit

1. Avancimi brenda arsimit fillor.
2. Avancimi prej arsimit fillor në arsimin e mesëm të ulët.
3. Avancimi brenda arsimit të mesëm të ulët.
4. Avancimi prej arsimit të mesëm të ulët në arsimin e mesëm të lartë.
5. Avancimi brenda arsimit të mesëm të lartë.
6. Avancimi prej arsimit të mesëm të lartë në arsimin e lartë.
7. Avancimi për nxënësit me njohuri të përgjithshme dhe me sukses të dalluar mund të bëhet vetëm brenda një niveli dhe mund të avancohet vetëm për një klasë.
8. Avancimi për nxënësit me talent në ndonjë lëndë apo fushë lëndore mund të bëhet brenda një niveli, prej një niveli në nivel tjetër dhe avancimin e tërë nivelit.

Neni 6

Procedura paraprake për avancim të nxënësit

1. Kërkesën dhe propozimin me dokumentacion të nevojshëm për avancim të nxënësit drejtorja e shkollës ia paraqet Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) më së largu deri me 20 janar të vitit vijues.
2. Kërkesën për avancim të nxënësit DKA e shqyrton më së largu deri më 10 shkurt të vitit vijues dhe lidhur me të nxjerr vendim për miratim ose për mosmiratim të

kërkesës për avancim. Nga një kopje e vendimit i dorëzohet drejtorisë së shkollës dhe nxënësit. Kërkesën e miratuar me dokumentacione përkatëse e dorëzon në Sektorin e Vlerësimit – MASHT/ kryetarit të komisionit për avancim të nxënësve, më së largu deri më 1 mars të vitit vijues.

3. Pala e pakënaqur me vendimin e DKA-së mund t'i paraqes ankesë Komisionit për ankesa të MASHT-it në afatin prej 3 ditësh prej ditës së pranimi të vendimit. Kryetari i komisionit të MASHT, lidhur me ankesën nxjerr vendim më së largu deri më 20 shkurt të vitit vijues. Vendimi i Komisionit të MASHT është definitiv.
4. Komisioni për avancimin e nxënësve më së largu deri më 10 mars të vitit vijues përgatit listën e nxënësve që duhet të përfshihen në testin për avancim, lista miratohet nga Sekretari i përhershëm i MASHT .

Neni 7 **Testi i inteligjencës**

Para se të bëhet procesi i vlerësimit të njohurive dhe shkathtësive, nxënësi duhet t'i nënshtrohet testimit para komisionit, për matjen e inteligjencës, pranë institucioneve shtetërore profesionale, pranë Fakultetit të Mjekësisë.

Neni 8 **Njoftimi i nxënësit për fitimin e të drejtës për të hyrë në testin për avancim**

1. Sektori i Vlerësimeve më së largu deri me 20 prill të vitit vijues e njofton nxënësin dhe drejtorinë e shkollës për të drejtën e fituar për të hyrë në testin për avancim.
2. Testimin për avancim e organizon Sektori i Vlerësimeve - MASHT.
3. Testimi organizohet prej datës 5 maj deri më 30 qershor të vitit vijues.
4. Për datën dhe vendin e testimit për avancim, nxënësi njoftohet nga kryetari i komisionit (Sektori i Vlerësimeve-MASHT).

Neni 9 **Testi për avancim**

1. Testin për avancim të nxënësve e përpilon Sektori i Vlerësimeve – MASHT apo e koordinon procesin e vlerësimit edhe me komisionin vlerësues po të atij niveli që nxënësi kërkon të avancohet.
2. Testi për avancim përbëhet nga përmbajtjet programore të klasës ose të nivelit arsimor të cilin nxënësi kërkon që ta kryej nëpërmes avancimit.
3. Testi për avancim të nxënësit me talent të veçantë përmban përmbajtjet programore të fushës së caktuar për klasën ose nivelin, të cilin ai kërkon që ta kryej nëpërmes avancimit.
4. Testi për avancim përbëhet nga:
 - 4.1 50 kërkesa (pyetje) për nxënësit e arsimit fillor;
 - 4.2 100 kërkesa (pyetje) për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët;
 - 4.3 120 kërkesa (pyetje) për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë;
5. Përqindja e pyetjeve në testin për avancim për lëndët mësimore, përcaktohet në bazë të përfaqësimit të tyre në planin dhe programin mësimor.

Neni 10
Vlerësimi i nxënësit

1. Nxënësi mund të vlerësohet në mënyrë të kombinuar, me shkrim me gojë dhe me ndonjë formë tjetër që është e përshtatshme.
2. Nxënësi me talent të veçantë mund të vlerësohet në mënyrë të kombinuar, me test dhe me ndonjë formë tjetër që është e përshtatshme për fushën e caktuar.

Neni 11
Kohëzgjatja e testimit

Testimi i nxënësve zgjat prej 3 deri në 6 orë dhe mbahet brenda 1- 4 dite.

Neni 12
Fitimi i së drejtës në avancim

Nxënësi fiton të drejtën për avancim, nëse në test ka arritje mbi 90 % për çdo lëndë mësimore.

Neni 13.
Shpallja e rezultateve

1. Rezultatet e testit për avancim shpallen më së largu tre ditë pas mbajtjes së testimit.
2. Nxënësi i pakënaqur ka të drejtë që në afatin prej tre dite prej ditës së shpalljes së rezultatit të kontrollojë testin në prezencën e kryetarit të komisionit. Nëse konstatohet se gjatë procesit të vlerësimit ka pas lëshime, ato do të evitohen.

Neni 14
Formimi i Komisionit për avancim

1. Sekretari i përhershëm merr vendim për caktimin e komisionit për avancim.
2. Sekretari cakton anëtarët e përhershëm dhe anëtarët vlerësues të komisionit i cili koordinon procesin e avancimit të nxënësve në përbërje:
 - 2.1. **Anëtarët e përhershëm:**
 - 2.1.1 Sektori i Vlerësimit: 1 përfaqësues – kryetar komisioni
 - 2.1.2 Administrata e arsimit parauniversitar: 1 përfaqësues – anëtar
 - 2.1.3 Institucionet arsimore: 1 përfaqësues – anëtar.
 - 2.2. **Anëtarët vlerësues:**
 - 2.1.1. Grupi vlerësues në lëndë përkatëse
 - 2.1.1. Ekspert i arsimit special (për avancim të nxënësit me nevoja të veçanta)
3. Anëtarët e përhershëm të komisionit kanë mandat 3 vjet.
4. Anëtarët e përhershëm të komisionit kanë mandat 3 vjet.
5. Komisioni nxjerr rregullat e punës dhe vepron sipas tyre.
6. Komisioni cakton orarin vendin dhe kohën e procesit të vlerësimit.
7. Anëtarët vlerësues caktohen nga anëtarët e përhershëm dhe bashkë kryejnë procesin e vlerësimit.
8. Komisioni në afatin prej 3 ditësh, nga dita e përfundimit të testimit për avancim,

përgatit raportin me shkrim, të cilin ia dorëzon Sekretarit të përhershëm të MASHT.

Neni 15

Avancimi i nxënësve

1. Sekretari i përhershëm i MASHT-it, në bazë të raportit të komisionit, në afat prej 5 ditësh nxjerr vendimin për avancimin e nxënësit.
2. Kryetari i komisionit për avancim Vendimin ia dorëzon nxënësit dhe shkollës.
3. Nxënësi i avancuar fiton të drejtën që të regjistrohet në klasën ose në nivelin e arritur me anë të avancimit.
4. Vendimi për avancim të nxënësit shpallet në organin zyrtar të MASHT-it dhe evidentohet në ditar për klasën e avancuar me Vendim, me nr dhe datë të vendimit, po ashtu edhe në librin amë të nxënësve të shkollës së evidentuar - Vendimin me nr. dhe datë.

Neni 16

Vendimi për avancim të nxënësit në arsimin e lartë

Nxënësit e avancuar me talent të veçantë, prej arsimit të mesëm të lartë në arsimin e lartë mund të regjistrohen në drejtimin përkatës për të cilin është avancuar pa iu nënshtruar testit të maturës, në të kundërtën nuk ka mundësi të regjistrohet në drejtime të tjera.

Neni 17

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohen udhëzimet administrative:
Mundësia e avancimit të nxënësve me nr. 25/2003 i dt. 19.11.2003 dhe Procedura për realizimi e procesit të avancimit të nxënësve nr. 3/2006 dt. 11.01.2006.

Neni 18

Hyrja në fuqi e Udhëzimit administrativ

1. Ky Udhëzim administrative hyn në fuqi me nënshkrimin i tij.

Enver Hoxhaj, ministër